

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastuar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-3682/1 datë 05.09.2024 dhe Konkluzionin ark. nr.02-3712/3 datë 12.09.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 35-të mbajtur më 12.09.2024, miratoi si vijon:

Aktvendim për vërejtje publike dhe përjashtim të ritransmetimit të shërbimeve programore

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime KOMBO 2003 SHPK eksport-import Kumanovë, për shkak se ka ritransmetuar shërbime programore që nuk janë të regjistruar në Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-3682/1 datë 05.09.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime KOMBO 2003 SHPK eksport-import Kumanovë, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, përkatësisht të përjashton ritransmetimin e shërbimeve programore.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për vërejtje publike dhe përjashtimin me ritransmetim të shërbimeve programore.

4. Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, pra vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky aktvendim është përfundimtar, dhe dita për miratim do të llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LSHMAAV ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV ose të rregulloreve të miratuara në bazë të Ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve për leje.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorimin) e programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të pakos programore të ritransmetuar nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia me datë 02.09.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të pakos programore të ritransmetuar nga ana e operatorit Shoqërisë për telekomunikacion dhe shërbime KOMBO 2003 SHPK

eksport-import Kumanovë, nga ku konstatoi se operatori në fjalë i cili sipas njoftimit nga Agjencia për Komunikime Elektronike mund të ushtroj veprimtarin në teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 02.09.2024, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor, që nuk përfshihet me çertifikatën për regjistrim të shërbimit programor të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të paraqitura në mënyrë të detajuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-3682/1 datë 05.09.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141, paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-3682/1 datë 05.09.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3712/3 datë 12.09.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, paraqitur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilin subjektin në fjalë t'i shqiptohet masë vërejtje publike dhe urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që të përjashton ritransmetimin e shërbimeve programore.

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhëresës, përkatësisht sipas vërejtjes publike dhe nëse ka përjashtuar ritransmetimin e shërbimeve programore.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-3682/1 datë 05.09.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.